




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 2008/28, nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, nenit 4 paragrafi 1 të Rregullores për ndarjen e ndihmave momentale në të holla nr. 01-013/860 të datës 17.07.2012, Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë shqyrtoi kërkesën e Shoqatës së Pensionistëve të Komunës së Vitisë dhe lidhur me këtë morri këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË**  
**PREJ 300,00€ SHOQATËS SË PENSIONISTËVE TË KOMUNËS SË VITISË**

**I.**

Kryetari i Komunës së Vitisë **INDAN** ndihmë financiare në shumë prej **300,00** ( treqind euro ), Shoqatës së Pensionistëve të Komunës së Vitisë në emër të mbështetjes financiare për kryerjen e aktiviteteve të kësaj shoqate.

**II.**

Mjetet nga neni I i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga kodi buxhetor për subvencione i Zyrës së Kryetarit të Komunës së Vitisë.  
Mjetet nga neni I i këtij vendimi derdhen në llogari të Shoqatës së Pensionistëve në Viti.

**III.**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë.

**IV.**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË  
Sokol Haliti



Vendimi u dorëzohet:

1. Xhemajl Rustemi - Kryetarit të shoqatës
2. Zyrës së Kryetarit,
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi